



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.927/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Hafiz Krasniqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Makoc, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Makoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Hafiz Krasniqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Makoc, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Makoc.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Makoc, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Makoc, në Vendvotimin: 1940/E/02R, 1940E/03D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 10.11.2017, e parashtruar nga Hafiz Krasniqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Makoc, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ku pretendon se në vendvotimin 1940E/02R i ka poseduar 64 vota ndërsa pas rezultatit përfundimtar posedon 63 vota. Më tej thekson se duhet të jenë 64 vota sipas shënimit të parë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, Paneli ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të

Rezultatit. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur në pjesën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura Paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha me sipër bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.927/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyndi Hazri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.